

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË KOSOVË

Data: 12 maj 2022 (09:00-16:30)

Vendi: Shoqata e Bankave të Kosovës

QËLLIMI I TRAJNIMIT

Qëllimi i trajnimit është të përmirësojë nivelin e ndërgjegjësimit në lidhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave të aplikueshme në Kosovë. Në veçanti, trajnimi do të trajtojë detyrimet që kanë entitetet në Kosovë që kontrollojnë dhe përpunojnë të dhëna personale të qytetarëve të vendosur në Kosovë dhe të qytetarëve të vendosur në Bashkimin Evropian.

OBJEKTIVAT

Trajnimi është specifik dhe i përgatitur me fokus për industrinë financiare në Kosovë. Synimi kryesor i trajnimit është që deri në fund të trajnimit, përfaqësuesit e institucioneve financiare të fitojnë njohuri të mjaftueshme lidhur me detyrimet që ata dhe institucioni ku punojnë kanë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të shpjegojnë se çka janë të dhënat personale, mbi çfarë baze mund të merren dhe përpunohen të dhënat personale, cilat janë detyrimet e institucionit financiar si kontrollues dhe përpunues i të dhënave personale, çfarë të drejta kanë qytetarët të dhënat e të cilëve përpunohen, a zbatohet GDPR në Kosovë, dhe tema të tjera me rëndësi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë.

TARGET GRUPI

Përveç personave që merren me mbrojtjen e të dhënave, në trajnim mund të marrin pjesë edhe personat nga dep. i shitjes, marketingut, collection, ligjor dhe i operacioneve. Trajnimi nuk do të jetë vetëm në nivel teorik se çka përmban ligji dhe çka janë detyrimet ligjore, mirëpo do të trajtohen dhe diskutohen rastet në praktikë, ku jo vetëm zyrtarët për mbrojtje të të dhënave janë të involvuar. Prandaj, çdo staf që ka qasje në të dhëna personale, është i mirëseardhur të ndjekë trajnimin.

GJUHA

Trajnimi mbahet në gjuhën shqipe!

Mbrojtja e të dhënave personale në Kosovë

Data: 12 maj 2022 (09:00-16:30)

TRAJNER

Kushtrim Palushi, është Avokat dhe Partner Menaxhues në Shoqërinë e Avokatëve RPHS Law i specializuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Kushtrim Palushi mban titullin LL.M. (Master i Drejtësisë) nga Universiteti Notre Dame, ShBA, me fokus në të Drejtën Ndërkombëtare, Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Ndërkombëtare dhe të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Kushtrim Palushi, gjatë vitit 2018 ka qenë i angazhuar si ekspert për Qeverinë e Kosovës si pjesë e grupit punues për draftimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike në Kosovë.

PERFITIMET NGA TRAJNIMI

- ✚ Njoftim mbi rëndësinë e caktimit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale
- ✚ Njoftim mbi rëndësinë e caktimit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale
- ✚ Nevoja për respektimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale
- ✚ Transferimi i njohurive nga pjesëmarrësit tek anëtarët e tjerë të kompanisë

PËRMBLEDHJE E PIKAVE TË TRAJNIMIT

- ✚ Hyrje dhe përmbledhje e trajnimit
- ✚ Subjekti dhe përpunuesi i të dhënave
- ✚ Parimet mbi përpunimin e të dhënave
- ✚ Pëlqimi për përpunim të të dhënave
- ✚ E drejta në qasje, korigjim dhe shlyerje
- ✚ Transferimi i të dhënave
- ✚ Vendimmarrja e automatizuar
- ✚ Detyrimet e kontrolluesit dhe përpunuesit
- ✚ Regjistrat e aktiviteteve dhe aktet e brendshme
- ✚ Siguria e të dhënave
- ✚ Aplikimi i GDPR në Kosovë
- ✚ Diskutim i rasteve në industrinë financiare
- ✚ Diskutim me përfaqësues të AIP

REGJISTRIMI

Ju lutem të plotësoni formën e regjistrimit dhe ta dërgoni përmes emailit në SHBK ose na kontaktoni në: kbatrainingcenter@bankassoc-kos.com or **038 246 171**